



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 648/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Ismet Jashari, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet pjesërisht** si i bazuar apeli i Ismet Jashari, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik LDK, dega në Podujevë, për vendvotimin 1837E/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa e Ismet Jashari, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, sa i përket vendvotimeve: 1823E/01R dhe 1817E/01R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel ZL.Anr.648/2017 me datën 09.11.2017, nga Ismet Jashari, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik LDK, në të cilën thekson se në vendvotimet: 1837E/01R, 1823E/01R dhe 1817E/01R, në të cilën pretendon se votat e tij i janë bartur një kandidati tjetër të të njëjtit subjekt politik LDK. Më tej thekson se e kanë votuar familjarët, andaj në apel i ka cekur emrat e votuesve dhe apelit i ka bashkangjitur edhe deklaratat e tyre.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Apeli është pjesërisht i bazuar**

Paneli, me datë 11.11.2017, në përbërje të ekipit hetues të PZAP-it, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 1837E/01R, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati nga subjektit politik LDK, dega në Podujevë, ka poseduar 38 vota në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i apelit i posedon 17 vota të vlefshme.

Sa i përket pjesës refuzuese si në pikën IV të këtij vendimi, paneli pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit i vlerësoj si te pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsyes se gjatë hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me datë 11.11.2017 në kutitë e votimit: 1823E/01R dhe 1817E/01R në QNR, konstatoi se në vendvotimi 1823E/01R dhe 1817E/01R në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL.Anr.648/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesues i Panelit**  
**Gyltine Sylejmani**



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*